


KOMUNA SKENDERAJ OPSTINA SKENDERAJ			
Ndërmarrja Publike Lokale Lokale Javore Publike			
NPL "Eko Natyra" SH.A U.P. "Eko Natyra" A.D.			
Data Pranuor Dorzuar		16/10/2024	
Datumi Pranuor Dorzuar		16/10/2024	
Nr. Org. Org. Javore	Sht. Kesh. Kesh. Javore	Nr. Pror. Pror. Javore	Nr. Fajtove Javore
001	001	14/2024	002



Duke u bazuar në nenin 8 dhe nenin 10 par.2.2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, Nr.01/2024, si dhe Plotësim Ndryshimi Nr.03/2024, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në Rregulloren për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të Ndërmarrjes Nr.121/2021 neni 3 par.14, nenin 31 par.3 të Statutit të NPL "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj, Ndërmarrja Publike Lokale "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj, me datë **16.10.2024** shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i pozitës: Mirëmbajtës/e-Pastrues/e
Nr. i Pozitave: 1 (një) pozitë
Kohëzgjatja: Me afat të caktuar 1 vit me mundësi vazhdimi
Lloji i Punës: Jo i karrierës
Orari i punës: Me orar të plotë
Vendi i Punës: NPL "Eko Natyra" Sh.A, Skënderaj
Koeficienti: 3.5

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Mirëmbajtja/pastrimi i të gjitha hapësirave të brendshme në objekt
- Mirëmbajtja/pastrimi i orendive brenda hapësirave të objektit
- Mirëmbajtja/pastrimi i pajisjeve brenda hapësirave të objektit
- Mirëmbajtja/pastrimi i dritareve të objektit
- Mirëmbajtja/pastrimi, sipas kërkesave dhe nevojave të NPL "Eko Natyra" SH.A.

Kualifikimi dhe Aftësitë:

- Të ketë të kryer së paku shkollën fillore
- Kandidatet që kanë provoj punë kanë përparësi
- Të ketë aftësi për të punuar i/e pavarur, në punë ekipore si dhe në ambient dinamik

Procedura për Aplikim:


- Aplikacioni për punë – Kërkesa
- Letërnjoftimi kopje
- Diploma/Certifikata si dëshmi për kryerjen e shkollimit
- Certifikata nga gjykata që nuk është nën hetime

Sqarim: Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret, do të ftohen për intervistë.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** kalendarike nga dita e publikimit duke filluar nga data **16.10.2024** deri më **30.10.2024**.

Aplikacioni/Kërkesa merret si dhe dorëzohet e plotësuar dhe e kompletuar me të gjitha dokumentacionet tjera tek zyrat e NPL Eko Natyra Sh.A , Rr. "Ali Gashi" Skënderaj, prej orës 09:00 – 12:00 si dhe prej 13:00 – 15:00.

NPL Eko Natyra Sh.A Skënderaj

Kryeshefi Ekzekutiv

Z. Shemsi Maksuti

